



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.37

Prishtinë, më 09/10/2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Igor Simiq, Frashër Krasniqi, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Mungoi:** Arben Gashi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Shaban Murturi, Eusr/EU, Edita Kusari, Eusr/EU, Erblina Sejdiu, praktikante, Rrezearta Reka, Undp, Francesko Chialon, Undp, Labinot Leposhtica, Birn, Mehmet Krasniqi, EO, Melodia Abrashi, KDI, Donika Voca, KTV, Blerta Bejtullahu, Eusr/EU, Baban Simiq, Ngo-Aktiv, Ardita Hajra, Ngo-Aktiv, Mejreme Tahirukaj, Radio Kosova, Majlinda Sinani-Lulaj-IAP, Suzana Gashi, IAP, Sanije Berisha, OSBE dhe Saranda Bogujevci.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
3. Shqyrtimi i propozimeve me kandidatët për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas;

4. Shqyrtimi i Raportit të Avokatit të Popullit në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Projektligjin nr.06/L-079 për Efiçencë të energjisë;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Projektligjin nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete;
7. Diskutim lidhur me mos procedimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planit të Veprimit, në Kuvend, siç përcaktohet me nenin 16 të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
8. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët e komisionit me rendin e ditës dhe gjithashtu njoftoi se në mbledhje është ftuar edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, në mënyrë që të prezantojnë Raportin në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale.

**Hajdar Beqa** kërkoi sqarim rreth pyetjes së dytë dhe kërkoi nga inicuesit e kësaj nisme që të tërheqin këtë nismë duke u bazuar edhe në mendimin e Qeverisë, e cila nuk e mbështet këtë nismë aktualisht, me arsyetimin se ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale është i paraparë edhe me agjendën Legjislativë të Qeverisë, poashtu thekson se edhe Ministri i Drejtësisë ka thënë që deri në fund të vitit do të vijë Projektligji për Kodin e Procedurës Penale dhe kur të vijë Kodi mund të harmonizohen pikat. Ai poashtu shtoi se kjo nuk ka të bëjë me përmbajtjen, mirëpo kërkoi këtë në mënyrë që të krijohet një Kod më i mirë dhe i kompletuar i Procedurës Penale që të mos krijohen paralelizma.

**Kryetarja** tha se sipas Ministrisë të Drejtësisë Kodi i Procedurës Penale është dashur të procedohet më 30 qershor të këtij viti, mirëpo edhe pse kanë kaluar shumë muaj dhe ende nuk është proceduar. Kryetarja poashtu shtoi se kjo është nismë e Lëvizjes Vetëvendosje dhe ka të bëjë me gjykimin në mungesë të krimeve të kryera në Kosovë gjatë luftës, në momentin kur procedohet Kodi i Procedures Penale do të veprohet në përputhje me të gjitha ndryshimet që bëhen në ndërkohë, nëse kjo nismë kalon edhe në Kuvend. Ne jemi të detyruar ta zbatojmë në draftin e ri të Kodit të Procedurës Penale poashtu është në përputhje me ligjin, Kushtetutën nuk ka ndonjë shkelje të Rregullores dhe as të Kushtetutës, prandaj konsideroj se duhet ta procedojmë, theksoi deputetja Albulena Haxhiu.

**Hajdar Beqa** tha se nuk po e kontestojmë përmbajtjen e kësaj iniciative, mirëpo mos të krijohen paralelizma përderisa është në agjendën e Qeverisë. Ai propozoi që t'i drejtohen ministrisë të Drejtësisë, e ku do të kërkohet që të procedohet Kodi i Procedures Penale. Duke pasur parasysh

se është paralajmruar nga Qeveria se Kodi do të vijë brenda dy - tri jave, nuk është e nevojshme që të hyjë dy herë në grupe punuese, potencoï z. Beqa.

**Bilall Sherifi** tha se ky projektligj është i mirë sepse krimet e luftës të kryera ndaj popullsisë civile në Kosovë kërkojnë një trajtim sa më urgjent, sepse aktorët po vjetërsohen dhe dëshmitarët po vdesin. Kjo nuk bie në kundërshtim me agjendën e Qeverisë, sepse në momentin kur procedohet nga Qeveria, mund të bashkohen që të dyjat. Më tutje shtoi se përderisa për krimet e supozuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është krijuar një Gjykatë Speciale, atëherë së paku për krimet e kryera në Kosovë ndaj popullsisë civile pse të mos e krijojmë një mekanizem shtesë në mënyrë që krimineleve të mos u'a ndalojmë hyrjen në Kosovë, por kudo që ata kapen të dërgohen në vuajtje të dënimit. Duke pasur parasysh se kjo është një çështje e vonuar, le të procedojmë me këtë çështje, theksoi mes tjerash deputeti Bilall Sherifi.

**Kryetarja** tha se si komision do të ngarkohemi me nismën e Qeverisë për Kodin e Procedurës Penale edhe me këtë nismë gjithashtu, prandaj ne momentin kur vjen nisma nga Qeveria të koordinohen të dy projektligjet duke pasur parasysh se kjo nismë rregullon vetëm një çështje, ndërsa Kodi i Procedurës Penale do të trajtojë më shumë çështje.

**Sami Kurteshi** tha nuk kemi të bëjmë me dyfishim të punës sepse kjo vetëm integrohet në Kodin e Procedurës Penale kur të procedohet, patjetër që dikush mund të ketë vërejtje edhe në këtë tekst të sjellë nga Lëvizja Vetëvedosje mirëpo, nëse ka kështu konkurrencë që është vetem kualitativ është diçka e mirë, pres edhe nga subjektet e tjera të sjellin dokumente të tilla, tha deputeti Sami Kurteshi.

*Rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.*

## **2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës**

**Kryetarja** prezantoi Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, duke thënë se ky projektligj ka të bëjë me gjykimin në mungesë dhe është në përputhje me standardet e Unionit European. Rezoluta që është miratuar në Kuvend kur është diskutuar për të pagjeturit, pika 11 e kësaj rezolute ka të bëjë me hartimindhe procedimine projektligjiti cili mundëson gjykimin e të akuzuarve për krimet e luftës në mungesë. Pra, duke u bazuar në këtë rezolutë, por edhe në padrejtësitë e mëdha që janë bërë pas luftes gjatë këtyre gati 20 viteve, kemi konsideruar se duhet proceduar tutje me gjykimin në mungesë, ashtu siç është e rregulluar edhe në vendet e tjera të BE- së. Më tutje, kryetarja vazhdon me sqarimin se ky projektligj e ka për qëllim lejimin, hetimin, akuzimin dhe gjykimine të pandehurve në mungesë

duke i zbatuar standardet e së drejtës në gjykim të drejtë dhe parimet e tjera të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Poashtu është e rëndësishme që ky projektligj aplikohet vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë që i parasheh Kodi i Procedurës Penale. Më tutje thekson se është e vetëdijshme se ka nevojë edhe për ndërhyrje tjera të cilat mund të dalin, qoftë nga diskutimi në komision apo edhe në seancë të Kuvendit. Deputetja shtoi duke thënë se shumë shtete të Bashkimit European, prandaj konsideroj se duhet votuar ky projektligj edhe pse jemi vonuar, theksoi deputetja Albulena Haxhiu.

**Korab Sejdiu** tha se gjykimi në mungesë është njëra prej prioriteteve dhe të metave kryesore të Kodit aktual të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Shumë prej gjykimeve sikur ato për krime lufte edhe ato më vonë ose po stërzgjatën ose nuk po ndodhin fare për arsye se po mungon dikush, sidomos ato kur kemi më shumë se 1 të pandehur. Prandaj, ky është një ndryshim i nevojshëm për Kodin e Procedurës Penale. Më tutje propozoi që kur të formohet Grupi punues, të angazhohet një ekspert me një pervojë të ngushtë në aspektet procedurale të drejtës penale me qëllim që të mos bëhet ndonjë shkelje në këte drejtim.

**Kryetarja** tha se fokusi i tyre kryesor ka qenë që mos të bjerë ndesh me të drejtat e njeriut dhe standardet ndërkombëtare, prandaj jemi munduar që të përmbajë dispozita të duhura në këtë drejtim. Deputetja Haxhiu përkrahu propozimin e deputetit Sejdiu për angazhimin e një eksperti.

**Hajdar Beqa** tha se kodi që do të sjellet nga Ministria e Drejtësisë i ka të inkuorporuara çështjet të cilat janë adresuar në këtë projektligj, pra që ka të bëjë me gjykimin në mungesë, si dhe shumë çështje të tjera të cilat i kontribuojnë sistemit të drejtësisë në Kosovë. Prandaj konsiderojë se kjo iniciativë është e panevojshme në këtë fazë. z. Beqa u pajtua që në Grup punues të përfshihen ekspertë të jashtëm.

**Shkumbin Demaliaj** tha se për qytetarët e Kosovës është bërë një Gjykatë Speciale, ndërsa për ata që supozohet që kanë kryer krime në Kosovë të gjykohen në mungesë në Gjykata të Kosovës. Ai tha se është kundër këtij propozimi dhe shtoi duke thënë se duhet që edhe ata të gjykohen në Gjykata Speciale ose të prishet ligji për Gjykatën Speciale dhe të gjitha këto, qoftë të shqiptarëve apo të serbëve të jenë me një ligj të caktuar.

**Saranda Bogujevci** tha se në rezolutën që është miratuar në seancën e mbajtur për personat e pagjetur, njëra ndër pikat ka qenë që të hartohet dhe procedohet projektligji për gjykimin në mungesë për krime të luftës. Poashtu ka pasur shume raste, sidomos nëse flasim për krimet e dhunës seksuale gjatë luftës, ku nuk kanë mundur të dënohen kryeresit sepse nuk është mbajtur gjykimi. Prandaj ky është një projektligj shumë me rëndësi dhe shpresoj që të gjithë deputetët do ta përkrahin jo vetëm në komision, por edhe gjatë fazave të tjera.

**Kryetarja** tha se pas këtij projektligji duhet të bëjmë një projektligj tjetër i cili dokumenton të gjitha krimet që janë kryer gjatë luftës në Kosovë, është e pafalshme për ne që gati 20 vjet pas luftës nuk kemi ende dokumentim të krimeve të luftës. Është brengosese kur dihet se në Prokurorinë Speciale aktualisht ekziston vetëm një prokuror që merret me rastet e krimeve të

luftës, prandaj do të duhej që të bëjmë punën tonë si komision në mënyrë që të kërkojmë që numri i Prokurorëve Specialë që merren me rastet e krimeve të luftës të rritet.

*Pas diskutimeve komisioni nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-091 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

### **3. Shqyrtimi i propozimeve me kandidatët për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas**

**Kryetarja** tha se shumë prej kandidatëve të propozuar për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas nuk i plotësojnë kushtet e parapara me ligj. Pas diskutimeve që kishin anëtarët e Komisionit në lidhje me këtë çështje u pajtuan që të kërkohej nga institucionet përkatëse që anëtarët të cilët nuk e kanë të kompletuar dokumentacionin ta plotësojnë atë dhe ta sjellin në komision.

*Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:*

### **P ë r f u n d i m**

- I. Kandidatëve të propozuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale: Skender Asllani, udhëheqës i Divizionit për Skema Pensionale dhe Zemrie Limaj, U.D udhëheqëse e Divizionit, për hartim të Legjislacionit, në dosjet e tyre u mungojnë dëshmitë për plotësimin e kushtit, sipas nenit 14, paragrafi 1 i nënparagrafit 1.5 të Ligjit përkatës.
- II. Propozimi i kandidatëve nga Ministria për Kthim dhe Komunitete: Mita Staletoviq, zyrtar, Marko Sibinoviç, zyrtar dhe Milos Tanasijeviç, zyrtar, nuk është në pajtim me nenin 12, paragraf 6 të Ligjit përkatës, pasi tre kandidatët e propozuar janë nga radhët e komunitetit serb dhe poashtu në dosjet e tyre mungojnë dëshmitë për plotësimin e kushteve sipas nenit 14 të Ligjit përkatës.
- III. Kandidateve të propozuar nga Ministria e Financave: z. Shyqyri Hyseni, drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme; z. Orhan Devaja, menaxher i Burimeve Njerëzore dhe znj. Lumnije Hetemi, zyrtare në Departamentin e Tatimit në Pronë, në dosjet e tyre mungojnë dëshmitë sipas nenit 14, paragrafi 1 nënparagrafit 1.5 të Ligjit përkatës.
- IV. Kandidateve të propozuar nga OJQ-të, Nazife Jonuzi, Halit Gashi, dhe Fitore Shala, në dosjet e tyre mungojnë dëshmitë për plotësimin e kushteve sipas nenit 14, të Ligjit përkatës.

- V. Detyrohet, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së këtij përfundimi, të riprocedojë në Kuvend propozimet me kandidatët nga të gjitha institucionet përkatëse për anëtarë të Këshillit për Ndhimë Juridike Falas me dëshmitë për plotësimin e kushteve bazuar në nenin 14 të Ligjit Përkatës. Propozimet për kandidatët nga Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet të jenë në pajtim me nenin 12 të Ligjit Përkatës në mënyrë që të sigurohet përfaqësimi etnik.

#### **4. Shqyrtimi i Raportit të Avokatit të Popullit në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale**

**Kryetarja** tha se e konsideron këtë raport jashtëzakonisht të vlefshëm dhe të duhur. Ajo tha se meqë në mbledhje janë të pranishëm përfaqësuesit e avokatit të popullit ata edhe do ta prezantojnë raportin.

**Shkumbin Demailaj** tha se para disa ditëve janë bërë publike të dhënat personale të mijëra njerëzve në Kosovë, përfshirë këtu edhe invalidët e luftës, prandaj duke pasur parasysh se ky institucion, pra Avokati i Popullit nuk ka reaguar asnjëherë deri më sot në mënyrë demonstrative do të leshojë mbledhjen, theksoi deputeti Shkumbin Demaliaj.

**Igor Simiq** tha se nuk ka pasur mundësi ta lexojë raportin e dorëzuar nga Avokati i Popullit sepse ky raport nuk është sjellë edhe në gjuhën serbe.

**Kryetarja**, duke u përgjigjur në shqetësimin që ngriti deputeti Igor Simiq, tha se institucionet që procedojnë dokumente në Kuvend e kanë për obligim që t'i procedojnë në të dy gjuhët sepse Kuvendi nuk bën përkthimin e dokumenteve të cilat vijnë nga institucionet e tjera.

**Hajdar Beqa** tha se institucionet obligohen që të i sjellin raportet edhe në gjuhën serbe kur dihet se kjo kjo është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prandaj edhe duhet respektuar kjo Kushtetutë. Z. Beqa propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës në mënyrë që raporti të jetë i kompletuar në dy gjuhët!

**Kryetarja** tha se nuk është sjellë në gjuhën shqipe as dokumentacioni nga kandidatët e propozuar për Këshillin për Ndhimë Juridike Falas nga anët e serbëve.

**Frashër Krasniqi**, tha se mendon se parimi i njëjtë vlen sikur për aplikacionet e serbëve që është dashur të na sjellin edhe në gjuhën shqipe. Kjo është e garantuar edhe me Kushtetutë dhe ligj, prandaj nuk duhet diskutuar se nga kush bëhet përkthimi i materialeve.

**Korab Sejdiu** tha se qytetarët kanë të drejtë të komunikojnë me institucione në gjuhën e tyre

prandaj institucionet e kanë për obligim të zbatojnë këtë të drejtë dhe materialet të dorëzohen në dy gjuhët.

**Majlinda Lulaj** u përgjigj për shqetesimin e ngritur nga deputeti Shkumbin Demaliaj në lidhje me mos reagimin e Avokatit të Popullit sa i përket publikimit të dhënave personale, Institucioni i Avokatit të Popullit mbi bazën e mandatit që ka dhe në bazë kompetencave që i ka dhënë ligji, në rradhë të parë bazohet në ankesat që drejtohen në institucione, ky rast është përcjellë si situatë, mirëpo ka pasur gjithandej reagim të institucioneve dhe në raste të tilla kur ka reagim të institucioneve, ne tërhiqemi deri sa të shohim veprimet e institucioneve, theksoi znj. Majlinda Lulaj. Më tej ajo tha se është hapur tashmë si rast dhe është duke u trajtuar mbi bazën e ankesave që janë pranuar dhe mbi bazën e përceptimit që është krijuar në opinionin publik, Avokati i Popullit ka afatet kohore dhe në bazë të tyre edhe do të veprojë.

**Hajdar Beqa** tha se në këtë rast e mbështet kolegun Demaliaj sepse duke pasur parasysh se ky lajm ka qenë në të gjitha mediat atëherë Avokati i Popullit është dashur edhe në atë rast të merret me këtë çështje ex officio kjo thuhet edhe në raportin që është sjellë nga Avokati i Popullit me konkretisht te qëllimi i raportit pika dy ku thotë se “më 24 dhjetor 2007 Avokati i Popullit ka hapur rast për hetime ex officio”, pra sipas detyrës zyrtare, theksoi deputeti Hajdar Beqa.

**Sami Kurteshi** tha se ka dy kategori të shkeljeve të cilat duhet t’ i kemi parasysh 1.Kategoria e shkeljeve individuale dhe 2. Kategoria e shkeljeve të përgjithshme, në këtë rast kemi të bëjmë me një kategori individuale dhe secili ka të drejtë ankese. Çështja tjetër është se ne kemi një institucion i cili është i specializuar, së paku sipas ligjit, ajo është Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa Avokati i Popullit e ka për detyrë të hetojë çështjen deri në fund dhe të japë rekomandime me të cilat mund të pajtohem apo të mos pajtohem, theksoi deputeti Sami Kurteshi.

**Frashër Krasniqi** tha se beson që është një shkelje e madhe e të drejtave të njeriut me publikimin e listave të veteraneve, mirëpo Avokati i Popullit nuk është një institucion i reagimit ditor pa e hetuar çështjen fillimisht. Poashtu edhe në raportin që ne e kemi përpara Avokatit të Popullit ju është dashur 8 deri 10 muaj që ta pregadisë këtë raport. Këtu kemi të bëjmë me një çështje shumë të rëndësishme, siç është shkelja e të drejtës së votimit për shumë bashkëatdhetarë jashtë territorit të Kosovës. Shumë mirë që kanë hapur hetim sa i përket listave të veteranëve, mirëpo nuk duhet të kemi reagime të tilla vetëm për çështjet në të cilat jemi më të ndjeshëm personalisht. Nëse kemi këtë ndjeshmëri duhet ta kemi për të gjitha rastet, përfshirë edhe pse nuk ka ardhur raporti në gjuhën serbe, tha deputeti Frashër Krasniqi.

**Bilall Sherifi** tha se duke e pasur parasysh ndjeshmerinë që ka kjo çështje është dashur të reagojë më shpejt Avokati i Popullit në këtë rast, ndërsa sa i përket mediave, edhe ne po të ishim në anën e mediave do ta kishim bërë një gjë të tillë në këtë rast Prokuroria ka bërë shkeljen, duhet që kjo çështje të hetohet dhe të mësohemi që të mos e keqpërdorim pushtetin.

**Majlinda Sinani Lulaj** tha se Institucioni i Avokatit të Popullit ,si institucion i pavarur, e respekton pavarësinë e institucioneve të tjera, në këtë rast edhe të Prokurorisë dhe Sistemit të Drejtësisë. Me Kushtetuten e vendit parashihet Avokati i Popullit si i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet tjera të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës kështu që procesi i hetimit, kur hapim rast, kur e hetojmë dhe si e hetojmë si Institucion i Avokatit të Popullit është i pavarur. Ajo tha se asnjëri nga pushtetet në vend nuk e ka legjitimitetin as të drejtën të drejtohet me kërkesa specifike për të bërë diçka apo për të mos bërë, ndërsa sa i përket çështjes së përkthimit znj Lulaj kërkoi falje në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe tha se brenda ditës do të arrijë versionin i përkthyer në gjuhën serbe.

*Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se: Raporti i Avokatit të Popullit nuk është i përkthyer në dy gjuhë, komisioni vendosi që ta shtyjë këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e radhës.*

#### **5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Projektligjin nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë**

*Kryetarja paraqiti raportin me amendamente të Komisionit Funksional për Projektligjin nr. 06/L-079 për eficiencë të enrgjisë dhe meqë nuk kishte vërejte komisioni nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

- 1.Projektligji nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
- 2.Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Projektligjin nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete**

*Kryetarja paraqiti Raportin me amendamente të Komisionit Funksional për Projektligjin nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete dhe meqë nuk kishte vërejte komisioni nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

1. Projektligji 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Automjete, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.



## **7. Diskutim lidhur me mos procedimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planit të Veprimit, në Kuvend, siç përcaktohet me nenin 16 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit**

**Kryetarja** tha se ndonëse është fundi i vitit ende nuk është mirtuar Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit. Komisioni për Legjislacion ka diskutuar në maj për këtë çështje për faktin se vendimi i Qeverisë e ka përjashtuar Kuvendin, siç parashihet me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit, që institucioni i cili e miraton këtë strategji dhe planin e veprimit është Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kryetarja më tutje tha se edhe pse nga komisioni është kërkuar nga Qeveria që të riprocedojë strategjinë në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit ende nuk është riproceduar, dhe në bazë të konsultimetve me zyrtarët e Komisionit, si Komision është vendosur që përmes kryetarit të Kuvendit t' i dërgohet shkresë edhe njëherë Qeverisë që të riprocedojnë strategjinë në përputhje me Ligjin për Agjencinë kundër korrupsionit si vijon:

### **K ë r k e s ë**

Qeveria e Republikës së Kosovës ta riprocedojë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022, në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

## **8. Të ndryshme**

*Në këtë pikë të rendit të ditës komisioni nxori këtë:*

### **V e n d i m**

**Për formimin e grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-087 për Kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Projektligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.**

1. Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-087 për Kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, me këtë përbërje:

1. Shkumbin Demaliaj, kryesues,
2. Albulena Haxhiu, anëtare,
3. Hajdar Beqa, anëtar,
4. Arben Gashi, anëtar,
4. Igor Simiçq, anëtar,
5. Frashër Krasniqi, anëtar.

2. Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me këtë përbërje:

1. Hajdar Beqa, kryesues,
2. Bilall Sherifi, anëtar,

3. Sami Kurteshi, anëtar,
4. Korab Sejdiu, anëtar,
5. Bahrim Shabani, anëtar.

3. Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesveme këtë përbërje:

1. Albulena Haxhiu, kryesuese,
2. Korab Sejdiu, anëtar,
3. Bilall Sherifi-anëtar.

Mbledhja përfundoi në orën 14.50.

Kryetare e komisionit,

**Albulena Haxhiu**